

## KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Durrës, sot më datë 29 Gusht 2022, në selinë e shoqërisë M-INVEST SH.A me adresë në Durrës Maminas,VLASHAJ Autostrada Tirane-Durrës, Km.19, Zona Kadastrale 3796, Godina Deutschcolor sha, palët si më poshtë hartuan këtë kontratë shitje:

### **SHITESI :**

**Zj.Mia Muça**, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, e dtl. 06.07.1974, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H457061290;

### **BLERESI :**

**Shoqëria “DELTA” sh.a.** regjistruar në QKB me datë me NUIS K13127202W, me administrator z.Luan MUÇA, shtetas shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, i dtl. 05.08.1971, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H10805062A

***Palët e mësipërme kryen redaktimin e kësaj kontrate shitje aksionesh në vazhdim:***

Shitësi Mia Muça, është zotërues i 1(një) aksioni që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë M-INVEST SH.A, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e themeluar më datë 26.04.2018 dhe e regjistruar pranë QKB-së, me datë 02/05/2018, me NIPT L81702503O.

Kapitali i shoqërisë është në shumën 3,500,000 lekë, i zotëruar nga aksioneri i vetëm, si më poshtë:  
Znj.Mia Muça 1 (një) aksioni 100 % për shumën 3,500,000 lekë.

### **Objekti i kontratës**


Asambleja e aksionarit të vetëm të shoqërisë me vendimin e datës 29.08.2022, bazuar në Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë, etj., ka vendosur:

Shitjen e 50% të kapitalit të zotëruar në shoqëri nga aksionari Mia Muça, blesit Shoqëria “DELTA” sh.a..

Me këtë kontratë shitje bëhen ndryshimet si më poshtë:

- **Znj.Mia Muça, ishte**, aksionar i vetëm i shoqërisë dhe zotërues i 1(nje) aksioni, që përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë 3.500.000 lekë;
- **Shoqëria “DELTA” sh.a., behet**, aksionar i 50% të kapitalit të shoqërisë dhe zotërues i 1(një) aksioni, që përfaqëson 50% të kapitalit me vlerë 1.750.000 lekë.

**Cmimi i shitjes**



Çmimi i shitjes së aksionit, që përfaqëson 50 % të kapitalit të zotëruar nga aksionari Znj.Mia Muça, që transferohet nëpërmjet kesaj kontrate shitje në favor të bleresit Shoqëria “DELTA” sh.a është në vlerën 1.750.000 lekë ose kundërvlera në lekë në datën e kryerjes së transaksionit, në marrëveshje midis palëve dhe pasi të jetë verifikuar gjendja pasurore e shoqërisë dhe derdhja e kapitalit të regjistruar.

Blerësi në marrëveshje me shitësin, deklarojnë se dokumentimi i likuidimit të vlerës së plotë, bëhet vetëm nëpërmjet llogarisë bankare dhe palët nuk kanë asnjë pretendim tjetër.

Kalimi i pronesisë së aksioneve bëhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate nga shitësi në favor të blerësit.

### Garancitë

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetemi titullar i ligjshëm i aksioneve që po transferohet nëpërmjet kesaj kontrate dhe se ajo është e lirë nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

### Heqje dorë nga të drejtat dhe detyrimet

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë mbi aksionin që po e transferon nëpërmjet kësaj kontrate shitje në favor të Bleresit Shoqëria “DELTA” sh.a., i cili bëhet pronar i ligjshëm i këtij aksioni.

Kjo kontratë u hartua në 3 kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe palët pasi e lexuan, e kuptuan, deklaruan se janë dakort me sa më sipër, dhe e nënshkruan rregullisht.

**SHITËSI**

Mia Muça



**BLERËSI**

Shoqëria “DELTA” sh.a.



The stamp is circular with the text "REPUBLIKA E SHQIPERISE" at the top, "ALBANIA" at the bottom, and "Shoqëria delta sh.a." in the center.